

VENDIM
Nr.276, datë 29.10.2004

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “KORÇA”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “MRM” sh.p.k.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “MRM” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Korçës, licencë, duke autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Korçës, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen strukturat programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Albert Minga